

**VENDIM**  
**Nr.626, datë 7.9.2011**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.563, DATË 14.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE TË HOLLËSISHME TË BASHKËPUNIMIT TË SHËRBIMIT PËRMBARIMOR ME AGJENCINË E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA, SI DHE PAGESËN PËRKATËSE PËR SHËRBIMIN E PËRMBARIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 14 pika 4, e 28 pika 4 të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe të ligjit nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.563, datë 14.7.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas kreut III shtohet kreu III/1, me këtë përmbajtje:

**“KREU III/1**  
**EKZEKUTIMI I AKTIT TË REVOKIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA/TË KONFISKUARA**

1. Agjencia njofton përmbaruesin gjyqësor dhe, nëpërmjet tij, pronarin e pasurisë së sekuestruar/konfiskuar për aktin e revokimit të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar.

2. Dorëzimi i pasurisë së revokuar te pronari i pasurisë bëhet sipas procedurave të Kodit të Procedurës Civile dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës, të cilin përmbaruesi gjyqësor e merr nga administratori i pasurisë.

3. Në rastin e mosmarrjes në dorëzim të pasurisë nga pronari i saj, me kalimin e afatit 30 - ditor nga data e marrjes së njoftimit të aktit të revokimit të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar, Agjencia i kërkon gjykatës, që ka vendosur revokimin e aktit, heqjen nga administrimi i saj të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar.”.

2. Kreu IV ndryshohet, si më poshtë vijon:

**“KREU IV**  
**PAGESAT PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR**

1. Pagesat e shërbimit përmbarimor për ekzekutimin e aktit të sekuestrimit/konfiskimit përcaktohen sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Agjencia përjashtohet nga pagesa paraprake e shërbimit për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit/konfiskimit.

3. Tarifat e përcaktuara në këtë vendim aplikohen dhe për pagesat e shërbimeve përmbarimore, të cilat nuk janë kryer nga Agjencia deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**